



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ERZEN

Nr. 1346/6 Prot.

Tiranë, më 18.9. 2020

VENDIM

Nr. 2, datë 16.09.2020

PËR
MIRATIMIN E LEJES “PËR HAPJEN E PUS - SHPIMIT”, SUBJEKTIT “EMIRJAN
ABAZI”, NJËSIA ADMINISTRATIVE FARKË,
BASHKIA TIRANË.

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 12, pikës 2, të nenit 56, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, V.K.M –së Nr. 696, datë 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre” dhe të VKM-së nr.416, datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Zyrës së Administrimit të Burimeve Ujore Ishëm – Erzen – Mat, Këshilli i Basenit Ujor Erzen

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për hapjen e një pus shpimi”, subjektit “Emirjan Abazi”, Njësia Administrative Farkë, Rruga “Shefqet Ndroqi”, në koordinatat e mëposhtme sipas sistemit KRRGJSH:

X 486926.71

Y 4575285.69

Z 194 m

2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Ishëm – Erzen – Mat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Anastasi Meçi



KRYETAR

Suzana Jahollari

